



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

VENDIM

PËR MIRATIMIN E LISTAVE SHUMEMËRORE TË KANDIDATËVE PËR ANËTARË NË KËSHILLIN E BASHKIVE TË DEPOZITUARA NGA PARTIA G-99, Pjesëtare e KOALICIONIT "ALEANCA PËR SHQIPËRINË EUROPIANE", PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË VITIT 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 22.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për pranimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive: Korçë, Tiranë, Vlorë, të paraqitura nga Partia G-99 pjesëtare e Koalicionit "Aleanca Për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", dhe neni 73, pika 1, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Partia G-99, si dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N:

Partia G-99, me vendimin e KQZ-së nr. 227, datë 27.04.2019, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019. Me vendimin e KQZ-së nr.251, datë 07.05.2019, është regjistruar koalicioni "Aleanca për Shqipërinë Europiane", pjesë e të cilit është dhe Partia G-99.



Nr. 633 i Vendimit

Data 22.05.2019

Ora 17:00 e Vendimit

Për miratimin e listave shumëmemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "G-99", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Në bazë të nenit 67, dhe nenit 72, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", ka depozituar në KQZ listën shumemërore të kandidatëve të saj për anëtarë në Këshillin e Bashkive: Korçë, Tiranë, Vlorë.

KQZ, ka vendosur kthimin për plotësim të listës shumemërore të kandidatëve për këshillin e bashkive:

- Vlorë me vendimin nr. 431 datë 16.05.2019.
- Korçë me vendimin nr. 430 datë 16.05.2019.
- Tiranë me vendimin nr. 428 datë 16.05.2019.

Brenda afatit Partia G-99, ka plotësuar dokumentacionin sipas vendimit të KQZ-së vetëm për Bashkinë Vlorë, Korçë, Tiranë.

Në bazë të nenit 67, pika 3, KQZ duhet të regjistrojë kandidatët për kryetarë apo për këshillin e bashkive: Korçë, Tiranë, Vlorë pasi këto bashki administrohen nga më shumë se një KZAZ.

Bashkëlidhur kërkesës është depozituar dhe dokumentacioni përkatës, si më poshtë:

1. Listat shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive Korçë, Tiranë, Vlorë;
2. Deklaratat e kandidatëve të listave shumemërore, të cilët deklarojnë se gëzojnë të drejtën dhe vullnetin për të kandiduar për anëtarë këshilli në Këshillin e Bashkive: Korçë, Tiranë, Vlorë, të propozuar nga Partia G-99;
3. Kopje të dokumentit të identifikimit për të gjithë kandidatët e listave shumemërore;
4. Vërtetim i Kuvendit të Shqipërisë, nr. 1851/1. prot., datë 09.05.2019, sipas të cilit vërtetohet se Partia Socialiste, përfaqësohet nga 74 deputetë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.
5. Jetëshkrimin për të gjithë kandidatët e listës shumemërore;
6. Formularin e vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".
7. Procesverbal i dorëzimit të dokumentave të kandidimit.

Në mbledhjen e datës 22.05.2019 në bazë të nenit 73, të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve verifikoi listat shumemërore të kandidatëve për këshillin e Bashkive Korçë, Tiranë, Vlorë të Partisë G-99 dhe dokumentacionin bashkëngjitur të paraqitur dhe konstatoi se është në përputhje me kërkesat e parashikuara nga neni 67, pika 2, 4, 5 dhe 6 dhe neni 72 të Kodit Zgjedhor.

Në zbatim të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumemërore. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në Këshillat Bashkiak Korçë, Tiranë, Vlorë, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, nga ku rezulton se:



Nr. 633 i Vendimit

Data 22.05.2019

Ora 17:00 e Vendimit

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "G-99", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019

Lista shumemërore e Bashkisë Tiranë:

1. Kandidati me numër **rendor 24, z. Ermal Midat Bani** në bazë të vendimit nr. 359, dt.18.03.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është deklaruar fajtor për veprën penale të " Falsifikim i letrave me vlerë , falsifikim i dokumentave ", e në baë të nenit 184/1, 186/1, 55 të K.P dhe neni 406 i K.Pr.P është dënuar me 6 muaj burgim dhe 133.400 lekë gjobë. Në bazë të nenit 59 të K.P është urdheruar pezullimi i ekzekutimit të dënimit për 2 vjet me kusht. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 632 datë 19.11.2008 ka vendosur mos pranimin e ankimit. Rehabilituar në bazë te nenit 69 te Kodit Penal.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstaton se për personat e shënuar në listën shumemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë, sipas ligjit nr. 138/2015. KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbështetur në nenin 23, pika 1, germa "a", nenin 67, pikat 2, 4, 5, dhe 6, nenin 72, dhe nenin 73, pika 1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Bashkive: Korçë, Tiranë, Vlorë të Partisë G-99 pjesëtare të Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 633 i Vendimit

Data 22.05.2019

Ora 17:00 e Vendimit

Për miratimin e listave shumemërore të kandidatëve për anëtar në Këshillin e Bashkive të paraqitura nga Partia "G-99", pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019